



Datë: 25.09.2025

Numër Protokolli: 6433/2025

A.nr.1581/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj–Demi, anëtare, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1581/2025 të datës 11.08.2025 të parashtruar nga ankuesi N.K, kundër organit të punësimit: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1581/2025, e datës 11.08.2025, e parashtruar nga ankuesi, N.K.

A r s y e t i m

Nëpunësi Civil, N.K (*tutje referuar vetëm* ankuesi), më datë 11.08.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5352/2024, të regjistruar nën shenjë A.nr.1581/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndaj Njoftimit me numër protokolli 2258 të datës 27.06.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.08.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa kjo e fundit me datë 10.09.2025 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë, se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akti emërimit me numër protokolli 02770 të datës 26.08.2025, është e punësuar në pozitën e punës “*Inspektor për Silvikulturë Mbrojtje të Pyjeve dhe Gjueti*”, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Si rrjedhojë, i njëjti përmes shkresës me numër protokolli 2258 të datës 27.06.2025, i është drejtuar me njoftim për avancimin dhe ushtrimin e paligjshëm të pozitës zyrtare të z. M.R, Sekretares së Përgjithshme së MBPZHR-së, përmes të cilës ka kërkuar nga e njëjta dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në organin përkatës të punësimit, ndërmarrjen e masave ligjore për shfuqizimin apo korrigjimin e Vendimit me Nr.DP-APK-703/2015 të datës 03.09.2015, për avancim të kundërligjshëm në pozitë.

Ndërsa, nga shkresat e lëndës rezulton se e ankuesi nuk ka pranuar asnjë përgjigje kundrejt këtij njoftimi-kërkese, ashtu që i njëjti me datë 11.08.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimin ankimor për aprovimin e ankesës dhe detyrimin që Sekretarja e Përgjithshme e MBPZHR-së, në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj kërkesën e tij të datës 27.06.2025, dhe të nxjerrë akt administrativ në përputhje me dispozitatat ligjore në fuqi në lidhje me këtë shkresë me numër protokolli 2258.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...”* e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e datës 11.08.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, pasi që ankuesi ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas Njoftimit me numër protokolli 2258 të datës 27.06.2025, dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të parakohshme, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1581/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit N.K;
- Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.